



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut
Академија за судии и јавни обвинители Павел Шатев
Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik Pavell Shatev

DINAMIKA KOHORE PËR ZHVILLIMIN E PROVIMIT PRANUES NË AKADEMINË PËR GJYKATËS DHE PROKURORË PUBLIK „PAVELL SHATEV“

05 dhe 06 shtator 2023 (e martë dhe e mërkurë)

- Dhënia e testit psikologjik.

23 dhe 24 shtator 2023 (e shtunë dhe e diel)

- Dhënia e testit të integritetit.

16 tetor deri më 21 tetor 2023 (nga e hëna deri të shtunën) – dhënia e testit të kualifikimit

- Testi i kualifikimit jepet **në mënyrë elektronike**, me qëllim të kontrollit të njohurive të kandidatëve të regjistruar nga fusha e së drejtës materiale dhe procedurale, të së drejtës ndërkombëtare, të së drejtës së BE-së dhe aktgjykimet më të rëndësishme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Shpallja e rezultateve të testit të realizuar të kualifikimit (në pajtim me nenin 40 paragrafin 5 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik) – **Pas mbarimit të testimit elektronik shpallen rezultatet e kandidatëve të shprehura në pikë nën shifrat e tyre të provimit.**

Nga 25 tetori deri më 29 tetor 2023 (nga e mërkura deri të dielën) - dhënia e pjesës me shkrim të provimit praktik

- Provimi praktik ka për qëllim kontrollin e njohurive të përgjithshme juridike dhe aftësive të kandidatëve për pranim dhe ndjekjen e programit për trajnim fillestar i cili përbëhet nga:
 - pjesa me shkrim, dhe
 - pjesa me gojë.
- Provimi praktik jepet në afat prej dhjetë ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare të testit të kualifikimit (në pajtim me nenin 45 paragrafi 2 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik).

- Pjesa me shkrim përbëhet nga detyra e provimit për zgjidhjen e dy studimeve të rastit (një nga lënda penale dhe një nga lënda civile gjyqësore) (në pajtim me nenin 45 paragrafi 3 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik).

Nga 02 deri më 09 Nëntor 2023 (nga e enjtja deri të enjten) – dhënia e pjesës me gojë të provimit praktik

- Pjesa me gojë e provimit do të zhvillohet nga ana e Komisionit pranues në afat maksimumi prej shtatë ditësh pune **pas përfundimit të pjesës me shkrim** dhe e njëjta do të inçizohet (në pajtim me nenin 45 paragrafi 7 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik).

9 nëntor 2023 (e enjte) – Përcaktimi dhe shpallja e rezultateve të provimit praktik dhe të kualifikimit

- Në bazë të rezultateve të marra nga dy pjesët e provimit, përkatësisht përmbledhja e tyre aritmetike, Komisioni pranues përgatit listën e renditjes preliminare dhe e shpall atë në afat prej dy ditëve pune **pas dhënies së provimit** për të cilin Komisioni pranues përpilon procesverbal të cilin e nënshkruajnë anëtarët e Komisionit pranues dhe sekretari (në pajtim me nenin 46 paragrafi 1 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik).

10 nëntor 2023 (e premte) – E drejta e kundërshtimit të rezultateve të arritur në testim

- Kandidati që konsideron se përmbledhja e pikëve nga testi i kualifikimit dhe provimi praktik është llogaritur gabimisht ka të drejtë kundërshtimi drejtuar Komisionit pranues në afat prej një ditë pune **nga dita e publikimit të rezultateve në ueb faqen dhe tabelën e shpalljeve të Akademisë** (në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik).

14 dhe 15 nëntor 2023 (e martë dhe e mërkurë) – Komisioni pranues vendos ndaj rezultateve të testimit

- Komisioni pranues është i detyruar ndaj kundërshtimit të vendos **në afat prej tri ditë pune duke llogaritur nga dita e pranimi të ankesës** (në pajtim me nenin 47 paragrafi 2 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik).

21 nëntor 2023 (e martë) – Afati përfundimtar për parashtrimin e ankesave pranë Këshillit Drejtues

- Kundër vendimit të Komisionit, kandidati ka të drejtë ankese pranë Këshillit Drejtues në afat prej tri ditë pune, nga dita e pranimi të vendimit (në pajtim me nenin 47 paragrafi 3 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik).

24 nëntor 2023 (e premte) – Këshilli Drejtues merr vendim ndaj ankesave të kandidatëve

- Këshilli Drejtues vendimin lidhur me ankesën e merr më së voni në afat prej tre ditë, duke llogaritura nga skadimi i afatit për dorëzimin e ankesave kundër vendimeve të Komisionit pranues (në pajtim me nenin 47 paragrafi 4 nga Ligji i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë Publik);

Nga dhjetori - Fillimi i procedurës administrative gjyqësore

- Kundër vendimit të Këshillit Drejtues nga paragrafi 4, kandidati i pakënaqur në afat prej tre ditë nga dita e pranimi të vendimit mund të nis kontest administrativ para Gjykatës Administrative.
- Pas padisë, Gjykata Administrative vendos në afat prej pesë ditëve.
- Kundër vendimit të Gjykatës Administrative ankesa drejtuar Gjykatës së Lartë Administrative është e lejuar në afat prej tre ditëve nga dita e pranimi të vendimit të Gjykatës Administrative.
- Gjykata e Lartë Administrative pas ankesës vendos në afat prej pesë ditë nga data e pranimi të saj.

Shkurt 2024 – Shpallja e listës së renditjes me rezultatet përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar provimin dhe listës së renditjes së dëgjuesve

- Pas hyrjes në fuqi të vendimit nga neni 47 të këtij ligji, Komisioni pranues shpall listën e renditjes me rezultatet përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar provimin në ueb faqen e Akademisë.